



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 5/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 785/7 Prot.

Tiranë, më 11.03.2016

V E N D I M

Nr. 23, datë 11.03.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 785/1, dt. 16.11.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,

VËREJ SE:

Në zbatim të urdhrin të verifikimit nr. 785/1 prot., datë 16.11.2015, të Komisionerit, është nisur verifikimi i ligjshmërisë të procedurës së ndjekur për trajtimin e kërkesës së paraqitur nga nëpunësi *****, për kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ose në një pozicion të barasvlefshëm në shërbimin civil, pas përfundimit të periudhës së pezullimit.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara, rezulton se, nëpunësi ***** ka fituar statusin e nëpunësit civil, në nivelin specialist, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Tregut, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Konsumatorëve, në ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, në datën 27.04.2004 (*Shih aktin e konfirmimit në këtë pozicion, nr. 708/2 prot., datë 27.04.2004, të Departamentit të Administratës Publike*).

Në datën 30.03.2011, ka ndërprerë marrëdhënien e punës, për shkak të pezullimit, në bazë të nenit 22, të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", kombinuar me nenin 46 pika 2, të ligjit nr. 9095, dt. 03.07.2003 "Për shërbimin e jashtëm në RSH", që vepronte në atë kohë, për shkak të shoqërimit të bashkëshortes së tij, e cila me urdhrin nr. 61, datë 23.01.2011, të Ministrit të Punëve të Jashtme, është emëruar "Sekretare e Parë në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, në Pekin".

Mbi këtë bazë, nëpërmjet shkresës nr. 2607, datë 03.03.2011, Ministria e Punëve të Jashtme i është drejtuar ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, për miratimin e pezullimit nga shërbimi civil të nëpunësit *****, për aq kohë sa do të zgjaste qëndrimi i

bashkëshortes së tij, në detyrën e Sekretares së Parë në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Pekin.

Pas marrjes së këtij miratimi dhe njoftimit të Departamentit të Administratës Publike, ky i fundit, me shkresën nr. 629/1 prot., datë 30.03.2011, ka konfirmuar pezullimin e përkohshëm nga shërbimi civil të nëpunësit E. Sejdija. Me këtë rast është lidhur edhe një aktmarrëveshje, me nr.1949, datë 21/03/2011, ku Ministria merrte përsipër detyrimin të garantonte vendin e mëparshëm të punës, ose një pozicion të barasvlefshëm me të nëpunësit.

Pas përfundimit të mandatit të bashkëshortes të punonjësit ******, me shkresën nr. 337 prot., datë 16.09.2015, i është drejtuar MZHETTS, për plotësimin e detyrimit ligjor, për rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës, ose të barasvlefshëm me të, ashtu si ishte marrë përsipër dhe në marrëveshjen e lidhur midis palëve.

Ky institucion, me shkresën nr. 337/1 prot., dt. 29.09.2015, ka vënë në dijeni punonjësin se nuk mund të plotësohej detyrimi i marrë për sipër prej tyre, pasi ai nuk figuronte në regjistrin e nëpunësve të institucionit dhe se dosja e tij personale, nuk ndodhej në këtë Ministri, duke bërë sugjerimin që për plotësimin e këtij detyrimi duhet t'i drejtohej Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI).

Punonjësi i interesuar, mbi bazën e këtij sugjerimi, i është drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI) me shkresën nr. 6449 prot., datë 29.09.2015 dhe kjo e fundit ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 6449/1 prot., datë 07.10.2015 ku informon se, pas ristrukturimeve të bëra dhe ndarjes së drejtorive teknike, Drejtoria e Tregut të Brendshëm, ku punonjësi ishte emëruar specialist në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, i ka kaluar MZHETTS.

Në vijim të analizës së dokumentacionit të administruar, rezulton se në strukturën aktuale të MZHETTS, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 28, datë 27.02.2015, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes*", ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 43 datë 26.03.2015, aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Tregtare dhe Drejtoria e Mekanizmave të Tregtisë dhe Ndhmës Shtetërore, nuk ekzistojnë. Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit është riorganizuar brenda Drejtorisë së Tregut të Brendshëm dhe dy pozicionet e punës në të cilat pretendohet rikthimi i nëpunësit ******, janë plotësuar në mënyrë përfundimtare dhe për rrjedhojë nuk ekziston objektivisht mundësia për sistemimin e tij pranë këtij institucioni.

Ndodhur në këto rrethana, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me shkresën nr. 7373/4 prot, datë 27.11.2015, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, që në këtë rast është njësia përgjegjëse, duke e njoftuar për mungesën e vendeve të lira dhe pamundësinë e sistemimit të nëpunësit ****** në pozicionin e mëparshëm të punës, apo në ndonjë pozicion tjetër, me përshkrim pune të ngjashëm me pozicionin e mëparshëm.

Njëkohësisht, referuar nenit 56 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, i ka kërkuar njësisë përgjegjëse, të trajtojë këtë rast, duke parë mundësinë e transferimit të këtij nëpunësi, në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori dhe nëse kjo është e pamundur, siç parashikon dispozita e sipërpërmendur, ai të regjistrohët në një listë që mbahet nga njësia përgjegjëse, deri në sistemimin e tij në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

Kryerjen e gjithë këtyre veprimeve dhe korrespondencës së zhvilluar ndërmjet institucioneve që kanë marrë pjesë në këtë procedurë, ankuesi e ka konsideruar si zvarritje të procesit dhe mungesë vullneti nga ana e administratës së institucionit dhe njësisë përgjegjëse, për plotësimin e detyrimit ligjor për sistemimin e tij në punë dhe megjithëse ka kërkuar ndihmën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për vlerësimin e ligjshmërisë të veprimeve të kryera dhe marrjen e masave për vënien në vend të detyrimeve ligjore, nëpërmjet shkresës/përgjigje nr. 6001 dt. 14.01.2016 të Departamentit të Administratës Publike, kemi marrë dijeni për faktin që

ankuesi *****, ndërkaq, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt:

Rikthim në pozicionin e mëparshëm të punës,

Detyrimin e të paditurit, MZHETTS, për ti paguar paditësit, pagën e vendit të punës (pozicionit specialist), nga kërkesa e parë (shtator 2015), deri në ekzekutimin e këtij vendimi”.

Referuar parimit të sanksionuar në nenin 36, të Kodit të Procedurës Civile, që institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor dhe nenit 41, pika 3 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ku përcaktohet e drejta e nëpunësit civil për t’u ankuar në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative, ndaj çdo veprimi apo mosveprimi që cënon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil, në këtë rast, nuk është i nevojshëm investimi i mëtejshëm apo ndërhyrja nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 16 dhe 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me urdhrin e verifikimit, nr. 785/1 prot., datë 16.11.2015, “Mbi verifikimin e ligjshmërisë të procedurës së ndjekur për trajtimin e kërkesës së paraqitur nga nëpunësi *****, për kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ose në një pozicion të barasvlefshëm në shërbimin civil, pas përfundimit të periudhës së pezullimit”.
1. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si dhe kërkuesi, *****.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA